07/11/2020

Parku Arkeologjik i Fierit tashmë me aplikacion dhe tur virtual 360 gradë

Për të apasionuarit e Parkut Arkeologjik të Fierit, tashmë në dispozicion të tyre është edhe një aplikacion i ri që ofron vizitë virtuale në 360 gradë.

Aplikacioni është pjesë e bashkëpunimit të Ministrisë së Kulturës me Fondacionin SIG dhe është pjesë e programit të qeverisë shqiptare për digjitalizimin e aseteve kulturore në vendin tonë.
Ervin Rushitaj, ekspert i fondacionit SIG, u shpreh për ATSH-në, se “përmes këtij aplikacioni synojmë të sjellim sa më shumë turistë në vendin tonë duke iu ofruar atyre pamje reale në 360 gradë, që kur shihen nëpërmjet syzeve virtuale të japin ndjesinë e të qenit vërtetë në vendet që eksploron”.

Ky projekt sjell edhe një risi tjetër për Apoloninë, që është aplikacioni në dy platforma të mëdha android dhe IOS. Kemi integruar turin virtual në 360 gradë brenda aplikacionit, kemi integruar edhe monumentet e objektet që ofron Apolonia të cilat mund të shihen e dhe me përshkrimet e përshtatshme.

Ky aplikacion i vjen në ndihmë çdo operatori turistik, duke krijuar mundësinë e informimit paraprakisht mbi atë se çfarë pret një turist të shohë në Parkun e Apolonisë dhe është një instrument shtesë atraktiv.

Ornela Dyrmishaj, Drejtore e Parkut Arkeologjik të Fierit tha se, “aplikacioni i ri, bëhet për herë të parë për parqet arkeologjike në vendin tonë. Implementimi i tij në Parkun e Apolonisë sjellë afër publikut dhe vizitorëve, monumentet dhe ambientet e këtij parku veçanërisht sot në kushtet e situatës së pandemisë. Por vizitën virtuale 3D të Parkut të Arkeologjik mund ta shoh çdo kush që është i interesuar dhe dëshiron të mësojë e shoh më shumë nga ky park”.

Ky aplikacion është i rëndësishëm si për vizitorët vendas dhe ata të huaj, të cilët mund të shkarkojnë falas këtë aplikacion në telefonin e tyre. Gjithashtu ai është i rëndësishëm edhe për nxënësit e shkollave, që në këtë periudhë të pandemisë e kanë të vështirë të organizohen, por që nëpërmjet aplikacionit mund të zhvillojnë projektet e tyre mbi këtë park, në kuadër të programit Edukimi përmes kulturës, që kanë në shkollë.

Agron Xoxa përfaqësues i Bashkisë Fier, duke vlerësuar këtë iniciativë tha se, “projekte të tilla që kanë të bëjnë me turizmin në përgjithësi dhe veçanërisht turizmin kulturor janë me rëndësi dhe kanë gjithnjë mbështetjen e bashkisë Fier.
Bashkia Fier ka intensifikuar investimet në drejtim të nxitjes së turizmit. Vitet e fundit kjo bashki ka mbështetur rikonstruksionin e galerisë së arteve figurative, apo edhe investimet në teatrin e Bylisit krahas kalendarëve kulturore, që kanë impakt në rritjen e vizitorëve dhe turistëve në këtë zonë.

FOTOGALERI